

RAPORT I MONITORIMIT
JANAR – TETOR
2019



PROGRESI NË ZOTIMET PËR QEVERISJE TË MIRË 2 VITE PAS

Prishtinë / Prizren / Ferizaj / Pejë / Gjakovë / Gjilan / Mitrovicë



Nëntor, 2019

Përgatitur nga Debora Peci dhe Jetmir Bakija

E drejta e autorit © 2019. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Mendimet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht përfaqësojnë mendimet e Balkan Trust for Democracy, të German Marshall Fund of the United States, apo të partnerëve të tyre.

Ky grant është dhënë nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i German Marshall Fund of the United States.



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Metodologjia e monitorimit.....	4
Përmbledhje.....	5
Vlerësimi i Zotimeve për Qeverisje të Mirë Komunale.....	7
Zotimi 1 – Publikimi i vendimeve, rregulloreve dhe planeve urbane.....	7
Zotimi 2 – Publikimi i raporteve financiare dhe rezultateve të konkurseve...11	
Zotimi 3 – Konsultime publike në lagje dhe fshatra.....	13
Konsultimet për buxhet 2020 dhe KAB 2020-2022.....	15
Zotimi 4 – Transparenca në prokurim publik.....	17
Zotimi 5 – Raporti vjetor për realizimin e premtimeve zgjedhore.....	19
Zotimi 6 – Adresimi i ankesave qytetare në platforma online.....	20
Rekomandimet.....	21
Aneks 1: Zotimet e nënshkruara nga kandidatët për Kryetarë.....	24
Aneks 2: Vlerësimi i të gjitha zotimeve për gjashtë-mujorin e parë të 2019-tës.....	31
Aneks 3: Vlerësimi për dëgjimet publike për Buxhet 2020 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022.....	32
Aneks 4: Raportet financiare të tre-mujorit të parë të 2019-tës.....	33

Hyrje

Qeverisja e mirë formon bazën e besimit në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur. Kur zgjidhet një person në një post publik, ai apo ajo e ka përgjegjësi të ushtrijë atë post bazuar në praktika të qeverisjes së mirë, ndërsa qytetarët, të cilët e financojnë komunën e shtetin, e kanë të drejtë të qeverisen mirë. Mirëpo nocioni i qeverisjes së mirë shpesh mbetet i gjerë dhe jo i kapshëm për të dy palët, qytetarë e zyrtarë publik.

Andaj, në tetor të vitit 2017 në prag të fushatës zgjedhore për kryetarë të komunave, Demokraci Plus ka përpiluar gjashtë pika që mendojmë se janë nga më të rëndësishmet për një qeverisje të mirë në nivel komunal. Këto gjashtë pika janë kthyer në formë të zotimeve për të cilat Demokraci Plus ka kërkuar nga kandidatët për Kryetar të shtatë komunave më të mëdha në Kosovë që të zotohen formalisht se do t'i përmbahen në rast se zgjidhen në postin për të cilin garojnë.

Një gjë inkurajuese që në fillim ishte fakti se 50 kandidatë për kryetarë të komunave në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë ishin zotuar me nënshkrim brenda muajit tetor, 2017 se nëse zgjidhen në postin e kryetarit të komunës do t'iu përmbahen këtyre parimeve të qeverisjes së mirë lokale. Ndër nënshkruesit e këtyre zotimeve janë edhe kryetarët aktual të këtyre shtatë komunave.

Zotimet e nënshkuara nga kryetarët e komunave sa kanë qenë kandidatë janë mjaft të thjeshta për tu përmbushur dhe praktikuar në rast se ka vullnet. Aty kërkohet ose të publikohen dokumente publike ose të mbahen konsultime publike që edhe kërkohen ligjërisht. Me qëllim që të vlerësohet përmbajtja e konsultimeve publike, dhe jo vetëm se a janë përmbushur si obligim ligjor, në vitin 2019 Demokraci Plus ka përcjellur të gjitha dëgjimet buxhetore dhe dëgjimet për kornizën afatmesme buxhetore të mbajtura në këto

shtatë komuna, duke evidentuar secilën kërkesë të qytetarëve të shprehura në këto takime, si dhe përgjigjet që qytetarët kanë marrë nga zyrtarët komunalë prezent. Në dy zotimet e fundit kërkohet që të përpilohet një raport, sado i shkurtër, për progresin e realizimit të premtimeve zgjedhore të kryetarit dhe ndërmarrja e veprimit pas raportimeve të ankesave qytetare në ndreqe.com.

Në Aneksin 1 të këtij raporti janë të vendosura zotimet e plota ashtu si janë prezantuar për nënshkrim si dhe nënshkrimet e kandidatëve që janë zotuar se nëse zgjidhen kryetarë do t'iu përmbahen këtyre zotimeve. Qëllimi i këtyre zotimeve është të instalojë një qeverisje komunale të hapur, transparente dhe llogaridhënëse për qytetarët dhe grupet e interesit. Arsyeja pse janë përzgjedhur këto zotime është që të fillohet me disa parime bazë për një demokraci të mirëfilltë dhe të kemi përmirësim në këto parime qeverisëse. Ndërsa në Aneksin 2 të këtij raporti është i vendosur vlerësimi për përmbushje të zotimeve për periudhën Janar-Qershor 2019, ndërsa në Aneksin e 4 është i vendosur vlerësimi për publikimin e raporteve financiare për tre-mujorin e parë të vitit 2019. Vlerësimi i Demokraci Plus për dëgjimet publike për Buxhet 2020 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022 është i vendosur në Aneksin 3.



Monitorimi i përmbushjes së zotimeve është bërë në baza ditore, ndërsa vlerësimi është bërë në baza tre mujore me një vlerësim të përgjithshëm të të gjitha zotimeve në gjashtë mujorin e parë (periudha janar – qershor 2018), në vitin e parë të mandatit qeverisës (janar – dhjetor 2018), si dhe në gjashtë mujorin e parë të vitit të dytë të mandatit qeverisës (janar – qershor 2019).

Ndërsa shtatë komunat më të mëdha në vend janë përzgjedhur për arsye që përmbushja e zotimeve nga këto komuna do të duhej të shërbejë si shembull i mirë për komunat më të vogla përreth në vendosjen e standardeve më të larta të parimeve të qeverisjes së mirë në qeverisjen lokale në Kosovë.

Metodologjia e monitorimit

Pas rezultateve të zgjedhjeve lokale, në vitin 2018 D+ ka nënshkruar Memorandume të Bashkëpunimit me Kryetarët e zgjedhur të shtatë komunave më të mëdha (Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Gjilan dhe Mitrovicë), ku janë specifikuar rolet dhe përgjegjësitë e D+ dhe të komunës gjegjëse rreth aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit efektiv të nivelit të zbatimit të zotimeve elektorale.

Si burim i parë për publikim të informatave dhe dokumenteve që përbëjnë gjashtë (6) zotimet, është ueb-faqja e komunës. Me përdorimin e gjerë të internetit dhe teknologjisë informative, ueb-faqet duhet të shërbejnë si mjet primar për të zgjeruar transparencën institucionale.

Për këtë iniciativë monitorimi dhe vlerësimi, D+ ka angazhuar koordinator për secilën nga shtatë komunat, të cilët e bëjnë punën e monitorimit në baza të rregullta ditore në komunën e caktuar. D+ ka zhvilluar metodologjinë e monitorimit që konsiston në monitorimin e drejtpërdrejtë përmes pjesëmarrjes direkte të koordinatorëve të terrenit, në:

- Seanca të Kuvendeve Komunale;
- Diskutime publike, përfshi: takime me publikun, dëgjime buxhetore, konsultime publike në lagje apo fshatra, konsultime me bashkësitë lokale, dhe konsultime për rregullore;
- Seanca të Kuvendeve Komunale;
- Diskutime publike, përfshi: takime me publikun, dëgjime buxhetore, konsultime publike në lagje apo fshatra, konsultime me bashkësitë lokale, dhe konsultime për rregullore;
- Monitorimit të ueb faqeve zyrtare të komunave për publikim të:
- Vendimeve të Kryetarit;
- Vendimeve të Kuvendit Komunal;
- Planeve urbane;
- Raportit të shpenzimeve
- Rezultateve të konkurseve;
- Paralajmërimeve për diskutime publike;
- Kontratave;
- Planeve të prokurimit.

Gjithashtu, koordinatorët e terrenit janë angazhuar rreth verifikimeve të raportimeve të qytetarëve në platformën ndreqe.com, kanë informuar në baza javore zyrtarët e caktuar nga komuna për raportimet në komunën e tyre, dhe kanë verifikuar intervenimet/rregullimet e ndërmarra nga komuna.

Gjetjet gjatë monitorimit janë regjistruar në baza të rregullta në formularët e zhvilluar nga menaxhmenti i projektit, të cilat pastaj janë analizuar dhe ndarë me komunat respektive dhe publikun në mënyrë periodike.

Përmbledhje

Bazuar në monitorimin e shtatë komunave¹, Demokraci Plus ka bërë një vlerësim të nivelit të përmbushjes së gjashtë parimeve të qeverisjes së mirë për të cilat kryetarët e këtyre komunave, sa kanë qenë kandidatë për këtë post, janë zotuar me nënshkrim se do ti përmbushin në rast se zgjedhen. Gjetjet tona të monitorimit tregojnë se në përgjithësi publikimi i dokumenteve publike në ueb-faqe është përmbushur apo kryesisht i përmbushur, përveç në Komunën e Gjilanit dhe Prizrenit, të cilat kanë ngecje në publikim të vendimeve dhe rregulloreve. Komunat Gjilanit nuk ka të publikuar të gjitha vendimet të kuvendit dhe rregulloreve, kurse komuna e Prizrenit edhe pse ka të publikuar shumicën e vendimeve dhe rregulloreve, për këtë i duhet një numër i lartë mesatar i ditëve për t'i publikuar në ueb. Publikimi i raporteve financiare si duket në vitin 2019 ka pësuar regres, përderisa vetëm komuna e Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës kanë përmbushur këtë zotim si të plotë, edhe pse standardet e raportimit dhe detajet e raportimit dallojnë nga komuna në komunë. Në anën tjetër zotimi i tretë del të jetë realizuar mjaft mirë nga komunat e monitoruara, përderisa vetëm komuna e Prishtinës është vlerësuar se kryesisht ka përmbushur këtë zotim, kurse komuna e Mitrovicës është vlerësuar se ka plotësuar këtë zotim në nivel gjysmak. Megjithatë, për konsultime publike mbetet ende hapësirë për përmirësim, sidomos në përmbajtje të këtyre takimeve si dhe pjesëmarrjen qytetare. Edhe pse të gjitha komunat kanë respektuar afatet ligjore për ftesë në diskutime publike, pjesëmarrja e qytetarëve nuk është i nivelit të kënaqshëm, marrë parasysh se këto janë shtatë komunat më të mëdha në Kosovë. Inkurajuese që të gjitha nga shtatë komunat kanë vazhduar trendin e mbajtjes të konsultimeve publike, qoftë për buxhet, rregullore komunale apo plane rregulluese, megjithatë për qeverisje komunale kjo është mjaft e ulët.

Transparenca në prokurim publik ka nevojë të përmirësohet ende. Përderisa vitin e kaluar kjo ishte një praktikë e re, këtë vit komunat kanë vazhduar të mos jenë 100% transparente me qytetarët e vet. Janë vetëm komunat e Prishtinës dhe Gjakovës të cilat kanë publikuar të gjitha kontratat e nënshkuara, kurse komuna e Mitrovicës, Gjilanit dhe Ferizajt nuk kanë të publikuar shumicën e kontratave të nënshkuara. Në dy komunat e fundit janë gjetur edhe parregullsi ku kanë qenë kontrata të publikuara në ueb të komunës, pa qenë njoftimi në e-prokurim. Zotimi që më së paku është përmbushur nga shtatë komunat përgjatë këtyre dy viteve të monitorimit është publikimi i raportit për progresin e realizimit të premtimeve zgjedhore. Asnjëra komunë nuk i'u ka përmbajtur këtij zotimi. Përderisa në vitin 2018 komuna e Ferizajt kishte të publikuar një raport për "200 punë konkrete për Ferizajin dhe ferizajasit", ajo këtë vit nuk ka vazhduar me praktikën e njejtë. Kurse kryetari i komunës së Mitrovicës iu është përgjigjur Demokraci Plus duke thënë se kryetari aktual, z. Agim Bahtiri, nuk ka bërë asnjë premtim elektorale në fushatën e fundit zgjedhore. Sfidë mbetet edhe zotimi për adresimin e kërkesave të qytetarëve në ndreqe.com. Komuna e Prizrenit dhe Prishtinës

¹ Shtatë komunat e monitoruara janë komuna e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt, Pejës, Gjakovës, Gjilanit dhe Mitrovicës së Jugut.

vazhdojnë t'iu përgjigjen një pjese të konsiderueshme të këtyre kërkesave qytetare, ndërsa tjerat kanë shënuar fare pak progres në këtë fushë.








Në mungesë të bazës së krahasimit dhe për hir të transparencës, vendimet e kryetarit janë të paraqitura vetëm ato të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të komunave dhe kjo nuk e përjashton mundësinë se mund të ketë vendime tjera të miratuara por që nuk janë vendosur në ueb. Të gjitha komunat kanë respektuar obligimin për publikimin e planit të prokurimit në fillim të vitit kalendarik. Në këtë fushë janë monitoruar edhe rezultatet e konkurseve, por për shkak të mungesës të bazës së krahasimit nuk përjashtohet mundësia se mund të ketë rezultate tjera të konkurseve të cilat nuk janë publikuar. Fusha në të cilën komunat vazhdojnë të kenë ngecje është nxitja e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse që ndodhin në komunë.

Mbajtja e konsultimeve publike për plane të prokurimit nuk është respektuar nga asnjëri kryetar, as në vitin 2018 e as në 2019. Edhe pse ky zotim nuk është obligim ligjor, kjo nuk e mohon faktin që mbajtja e këtyre konsultimeve është një praktikë e mirë demokratike për të cilën kryetarët e tanishëm janë zotuar se do ta inkuadrojnë në mandatin e tyre qeverisës.

Si përfundim, sa i përket përmbushjes së zotimeve, është vërejtur një përpjekje më e madhe në plotësimin e atyre zotimeve që njëkohësisht janë edhe obligime ligjore. Kurse iniciativa për praktika të mira të qeverisjes lokale e që nuk janë të obligueshme me ligj, siç janë konsultimet publike për plan të prokurimit si dhe adresimi i raportimeve në platforma online – ndreqe.com vazhdojnë të neglizhohen nga udhëheqësit e komunave të monitoruara.

Vlerësimi i Zotimeve për Qeverisje të Mirë Komunale

Zotimi 1 – Publikimi i vendimeve, rregulloreve dhe planeve urbane

ZOTIMI 1: Publikimi i vendimeve, rregulloreve dhe planeve urbane	2019	Progresi nga viti 2018
Prishtina	 Përbushur	=
Prizren	 Gjysmake	▼
Ferizaj	 Kryesisht	=
Peja	 Përbushur	=
Gjakova	 Përbushur	=
Gjilani	 Nivel i ulët	=
Mitrovica	 Përbushur	▲

Për shkak të rëndësisë së informimit publik në funksion të transparencës në qeverisjen komunale, zotimi i parë i nënshkruar nga kryetarët aktual është publikimi i shpejtë i vendimeve të Kryetarit dhe Kuvendit Komunal, rregulloreve dhe planeve urbane në ueb faqen zyrtare të komunës. Në përgjithësi, zotimi i parë është përbushur plotësisht nga katër komuna, kryesisht i përbushur nga komuna e Ferizajt dhe me nivel të ulët të përbushjes nga komuna e Gjilanit. Vlerësimi është bërë duke marrë parasysh publikimin e vendimeve të Kryetarit dhe të Kuvendit të Komunës, përfshirë ditët mesatare nga marrja deri në publikim, dhe publikimin e planeve urbane në ueb faqe të komunës. Në këtë aspekt, komuna e Mitrovicës ka shënuar progres nga viti i kaluar, kurse komuna e Prizrenit ka shënuar rënie në përbushjen e këtij zotimi për shkak të mos-publikimit të vendimeve në kohë të shpejtë, duke qenë komuna më e ngadalshme në publikim të vendimeve nga shtatë komunat e monitoruara.

Vendimet e Kryetarit

Në përgjithësi, koha e publikimit të vendimeve nga data e marrjes së vendimit ndryshon dukshëm nga komuna në komunë. Përderisa komuna e Prishtinës, njëjtë si vitin e kaluar, vazhdon të jetë komuna më e shpejtë në publikimin e vendimeve të Kryetarit me zero ditë mesatare nga data e marrjes së vendimit, komuna e Prizrenit, me mesatare 44 ditë, është komuna e cila më së shumti vonon në publikimin e vendimeve të Kryetarit nga data e marrjes së tyre, duke shënuar rritje në vonesë nga vlerësimi i fundit i bërë në Qershor 2019, duke i shtuar 7 ditë në mesataren e numrit të ditëve pas të cilave publikohen vendimet dhe duke shtuar 20 ditë në krahasim me vitin e kaluar. Në nivel më të kënaqshëm të kohës së publikimit të vendimeve pas miratimit nga Kryetari janë komuna e Gjakovës dhe Gjilanit dhe Ferizajt të cilat i publikojnë vendimet e kryetarit në më pak se dy javë pas marrje së tyre, kurse komuna e Pejës dhe Mitrovicës janë komuna që iu duhen më shumë se dy javë për të publikuar një vendim. Komuna e Gjakovës Pejës, Ferizajt dhe Gjilanit kanë shënuar përmirësim të dukshëm në kohën e publikimit të vendimeve të Kryetarit nga viti i kaluar. Vlen të theksohet se sa i përket numrit të vendimeve të publikuara, komuna e Gjilanit edhe këtë vit vazhdon të jetë komuna me më së paku vendime të publikuara, me 4 gjithsej, duke mos pasur rritje nga vlerësimi i fundit i bërë në Qershor 2019. Megjithatë, duhet të theksohet se Kryetarët kanë mundur që të marrin një numër më të madh të vendimeve se sa këto të listuara më poshtë, mirëpo në mungesë të bazës së krahasimit, dhe me qëllim të monitorimit të transparencës, në tabelën e mëposhtme paraqiten vetëm ato vendime të cilat janë publikuar në ueb faqe.

Tabela 1: Publikimi i vendimeve të Kryetarit

Vendimet e Kryetarit	Numri i vendimeve janar-tetor 2019	2018	Numri mesatar i ditëve nga marrja e vendimit deri në publikim 2019	2018
Komuna				
Prishtinë	42	123	0 ditë	0 ditë
Prizren	311	389	44 ditë	24 ditë
Ferizaj	107	201	19 ditë	27 ditë
Pejë	317	248	15 ditë	34 ditë
Gjakovë	198	331	12 ditë	17 ditë
Gjilan	4	3	8 ditë	163 ditë
Mitrovicë	146	103	21 ditë	16 ditë

Vendimet e Kuvendit

Në anën tjetër, numri i vendimeve të marra në Kuvend të Komunës është krahasuar me numrin e vendimeve të Kuvendit të publikuara në ueb faqen e komunës. Rregullorja për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, i obligon komunat që të publikojnë aktet normative në ueb faqen e komunës në një afat prej 15 ditësh, pas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nga Ministria përgjegjëse për vetëqeverisjen lokale².

Nga këto të dhëna shohim se komuna e Gjakovës vazhdon të jetë komuna më e shpejtë në publikimin e vendimeve të Kuvendit, me mesatarisht 8 ditë nga marrja e vendimeve e deri në publikim, njëkohësisht duke shënuar edhe përmirësim nga vlerësimi i fundit. Në anën tjetër, komuna e Prizrenit e ka kohën mesatare më të lartë për publikimi e vendimeve – 70 ditë – kurse ka të publikuara 15 vendime nga 19 gjithsej. Përmirësim nga vlerësimi i fundit ka shënuar komuna e Gjilanit, përderisa në gjatëmujorin e parë të vitit 2019 kishte të publikuara vetëm 8 vendime nga 28 gjithsej, ajo tash ka publikuar edhe pjesën më të madhe të tyre – 23 nga 38.

² Rregullorja nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Neni 16: "Publikimi i akteve normative në ueb faqen e komunës".

Tabela 2: Publikimi i vendimeve të Kuvendit

Vendimet e Kuvendit Komuna	2018	Numri i vendimeve të miratuara Janar-Tetor 2019	Numri i vendimeve të publikuara Janar-Tetor 2019	Numri mesatar i ditëve nga marrja deri në publikim Janar-Tetor 2019	2018
Prishtinë	72	53	53	19 ditë	22 ditë
Prizren	25	19	15	70 ditë	25 ditë
Ferizaj	112	57	55	26 ditë	36 ditë
Pejë	51	62	62	22 ditë	21 ditë
Gjakovë	64	52	52	8 ditë	15 ditë
Gjilan	54	38	23	36 ditë	32 ditë
Mitrovicë	72	42	42	23 ditë	20 ditë

Rregulloret

Komuna e Pejës ka miratuar numrin më të madh të rregulloreve në krahasim me gjashtë komunat tjera nën monitorim, konkretisht 5 sosh. Meqë numri i rregulloreve të miratuara nuk është indikatorë për performancën dhe transparencën e komunave në këtë vlerësim, publikimi i këtyre rregulloreve në ueb, si dhe mbajtja e konsultimeve paraprake publike për këto rregullore është aspekti i rëndësishëm për qeverisje të mirë komunale dhe transparencë. Numrin më të lartë mesatar të ditëve nga miratimi deri në publikim të tyre e ka komuna e Pejës me 30 ditë, ndërsa komuna e Gjakovës, Prishtinës, Mitrovicës kanë treguar efektivitet më të lartë në këtë aspekt. Komunat të cilat nuk i kanë të publikuara të gjitha rregulloret e miratuara janë komuna e Gjilanit e cila ka miratuar gjithsej katër rregullore në këtë periudhë, mirëpo të publikuar janë dy, komuna e Ferizajt ka miratuar dy rregullore kurse të publikuar e ka një dhe komuna e Prizrenit e cila ka miratuar tre rregullore kurse të publikuar ka vetëm 2.

Tabela 3: Publikimi i rregulloreve të miratuara

Rregulloret Komuna	Numri i rregulloreve të miratuara Janar-Tetor 2019	2018	Numri i rregulloreve të publikuara Janar-Tetor 2019	Numri mesatar i ditëve deri në publikim në ueb faqe Janar-Tetor 2019	2018
Prishtinë	4	4	4	19 ditë	24 ditë
Prizren	3	1	2	25 ditë	-
Ferizaj	2	4	1	17	83 ditë
Pejë	5	2	5	30 ditë	25 ditë
Gjakovë	4	2	4	5 ditë	22 ditë
Gjilan	4	11	2	23 ditë	48 ditë
Mitrovicë	4	7	4	23 ditë	26 ditë

Planet urbanistike

Planet urbane janë ndër aktet më të rëndësishme komunale dhe paraqesin interes publik për shkak se tregojnë si rregullohen lagjet dhe fshatrat ku qytetarët banojnë dhe si pritet të duken ato në të ardhmen. Andaj publikimi i tyre në ueb faqe të komunës është pjesë e zotimit të parë për Qeverisje të Mirë komunale. D+ ka monitoruar nëse komunat në fokus i kanë të publikuar gjatë kësaj periudhe planet urbane që janë aktualisht në fuqi dhe jo vetëm ato që mund të jenë miratuar në këtë periudhë qeverisëse pasi që këto plane janë afat-mesme dhe afat-gjata.

Tabela 4: Publikimi i planeve urbane

Planet Urbane	Numri i planeve
Komuna	
Prishtinë	24
Prizren	4
Ferizaj	Nuk ka
Pejë	13
Gjakovë	9
Gjilan	Nuk ka
Mitrovicë	7

Prishtina prin me numrin më të madh të planeve të publikuara (24), duke u ndjekur nga komuna e Pejë me gjithsej 13 plane urbanistike të cilat kanë qenë të publikuara edhe vitin e kaluar meqë janë plane afatgjate. Edhe pse në numër më të vogël, edhe komuna e Gjakovës (9), Mitrovicës (7) dhe Prizrenit (4) kanë të publikuara plane urbanistike të cilat datojnë para vitit 2018. Ndërsa komunat të cilat nuk kanë kurrfarë plani urbanistik të publikuar në web-in e tyre janë komuna e Ferizajt dhe Gjilanit. Mos publikimi i tyre në bën që banorët e tyre mundësi të marrin informata të shpejta dhe në mënyrë praktike nga ueb faqja e komunës për planin afatgjatë se si do të zhvillohet komuna dhe në bazë të tyre ta planifikojnë banimin, aktivitetet biznesore, shkollimin etj.

Zotimi 2 – Publikimi i raporteve financiare dhe rezultateve të konkurseve

ZOTIMI 2: Publikimi i raporteve financiare dhe rezultateve të konkurseve	2019	Progresi nga viti 2018
Prishtina	 Përbushur	
Prizren	 Kryesisht	
Ferizaj	 Nivel i ulët	
Peja	 Përbushur	
Gjakova	 Përbushur	
Gjilani	 Nivel i ulët	
Mitrovica	 Nivel i ulët	

Një tjetër parim i Qeverisjes së Mirë për të cilin janë zotuar kryetarët aktual në kohën kur ishin kandidatë për pozitë, është transparenca në shpenzimin e buxhetit komunal, konkretisht publikimi në ueb faqe në baza të rregullta dhe në kohë të arsyeshme, raportet tre mujore financiare. Ky zotim në fakt, është edhe obligim ligjor³. Poashtu, Kryetarët janë zotuar se do të jenë transparent me konkurset publike të komunës, duke i publikuar në ueb faqe rezultatet e të gjitha konkurseve.

Raportet financiare apo raportet e shpenzimeve, janë pasqyrë e të hyrave dhe shpenzimeve të komunës për çdo tre muaj të vitit, dhe kjo informatë është tejet e rëndësishme për shkak se tregon sa ka arritur zyra e Kryetarit të mbledh të hyrat e planifikuara për atë tre-mujor dhe si e ka shpenzuar buxhetin e miratuar nga Kuvendi në atë periudhë. Si i tillë pra është një vlerësim se ku qëndron komuna në çdo periudhë tre-mujorëshe dhe në varësi të kësaj situatë, bëhet planifikimi i mëtutjeshëm i aktiviteteve të komunës. Për më tepër është çështje me interes edhe për publikun dhe taksapaguesit të cilët kanë të drejtë të jenë të informuar se si shpenzohet paraja publike nga komuna e tyre në mënyrë periodike.

Gjatë monitorimit kemi hasur në disa çështje rreth praktikave të publikimit të këtij raporti të cilat e bëjnë sfiduese marrjen e këtyre informatave nga qytetarët. E para, është fakti që vendi i publikimit të tyre brenda ueb faqes ndryshon nga komuna në komunë. Disa komuna e vendosin atë tek vegëza e Investimeve Kapitale, disa në vegëzën e Drejtorisë së Financave, ndërsa komuna e Mitrovicës buxhetin e miratuar për vitin 2020 e ka vetëm tek vendimet e kuvendit. Në fakt në ueb faqet e reja është përcaktuar që ky raport të vendoset tek Investimet Kapitale, gjë për të cilën vlerësojmë se është çorientues sepse në fakt nuk është investim kapital por raport për shpenzimet e komunës. E dyta, është fakti që disa komuna e paraqesin atë në baza tre mujore ashtu siç edhe kërkohet, ndërsa disa të tjera e paraqesin në baza mujore, por në përgjithësi ka vonesa në publikim të këtij raporti. E treta, sa i përket formatit të tij, disa paraqesin dokumente të skenuara, disa në formatin excel, e kështu me radhë. Në këtë aspekt, është Komuna e Prishtinës ajo e cila përveç që publikon shumë shpejtë Raportet Financiare, në të njëjtën ditë pas miratimit në Kuvend, ajo këto raportime i publikon në formatin Excel, pdf dhe open data. Përveç formatit, ka edhe variacion në informatat që prezantohen në raportet financiare e që mungesa e konsistencës e bën të vështirë krahasimin mes komunave. E katërta, që është një ndër faktorët më shqetësues, është se qysh prej lansimit të ueb faqeve të reja në vitin 2018, me vonesën në publikimin e këtyre raporteve, komunat kanë manipuluar me datën e publikimit, duke vendosur një datë të mëhershme sesa nga ajo që është publikuar.

³ Ligji Nr. 03/L-48 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Neni 45: "Raportet tremujore buxhetore".

Përveç publikimit të raportit në ueb-faqe, raporti financiar duhet të dërgohet në Kuvend për informim dhe shqyrtim. Ky raport duhet të miratohet në Kuvend në mbledhjen e parë të Kuvendit pas tre-mujorit dhe më pas të publikohet në web. Edhe pse vlerësimi i përmbushjes së zotimeve është bërë deri më datë 31 Tetor 2019, Komuna e Prishtinës ka marrë notë pozitive në publikimin e raportit financiar të tre-mujorit të III-të, meqë mbledhjen e parë pas tre-mujorit Korrik-Shtator 2019 e ka mbajtur me datë 7 Nëntor 2019.

Tabela 5: Publikimi i raporteve të shpenzimeve

Raportet e shpenzimeve	Janar-Mars 2019	Janar-Qershor 2019	Janar-Shtator 2019	Buxheti 2020	KAB 2020-2022
Komuna					
Prishtinë	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar
Prizren	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është publikuar	Publikuar
Ferizaj	Publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar
Pejë	Publikuar (edhe në baza mujore)	Publikuar (edhe në baza mujore)	Publikuar (edhe në baza mujore)	Publikuar	Publikuar
Gjakovë	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar
Gjilan	Publikuar	Publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar
Mitrovicë	Publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar	Nuk është publikuar ⁴	Publikuar








Sa i përket rezultateve të konkurseve, është monitoruar numri i rezultateve të publikuara në ueb faqen e komunës. Nuk përjashtohet mundësia që mund të ketë rezultate tjera të konkurseve të cilat nuk janë publikuar në ueb, mirëpo në mungesë të një bazë të krahasimit, këto shifra tregojnë vetëm ato që janë publikuar në ueb gjatë vitit 2019. Në krahasim me vitin 2018, por edhe me vlerësimin e fundit të bërë në Qershor 2019, komuna e Pejës ka treguar përmirësim duke qenë se në Qershor nuk kishte asnjë rezultat të publikuar, kurse deri në Tetor 2019 ka të publikuara 10 rezultate, 8 më shumë sesa vitin e kaluar.

Tabela 6: Publikimi i rezultateve të konkurseve

Rezultatet e konkurseve	<i>Publikimi i rezultateve 2018</i>	Publikimi i rezultateve 2019
Komuna		
Prishtinë	28	43
Prizren	26	17
Ferizaj	39	22
Pejë	10	2
Gjakovë	88	43
Gjilan	9	10
Mitrovicë	31	21

⁴ Në pjesën "Vendimet e Kuvendit" është i publikuar vetëm buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës. Buxheti 2020 nuk figuron as në Drejtorinë e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, e as tek Investimet.

Zotimi 3 – Konsultime publike në lagje dhe fshatra

ZOTIMI 3: Konsultime publike në lagje dhe fshatra	2019	Progresi nga viti 2018
Prishtina	 Kryesisht	=
Prizren	 Përbushur	^
Ferizaj	 Përbushur	=
Peja	 Përbushur	=
Gjakova	 Përbushur	^
Gjilani	 Përbushur	=
Mitrovica	 Gjysmake	=

Një qeverisje e mirë kërkon që të konsultojë qytetarët për çështjet që i ndikojnë ata drejtpërdrejtë dhe për informim të vazhdueshëm të tyre. Konsultimet e rregullta me qytetarët qoftë për buxhet, apo për çështje specifike me rëndësi për banorët, por edhe takimet publike për informim të qytetarëve janë esenciale për një qeverisje të përgjegjshme, efektive dhe gjithëpërfshirëse. Në fakt, mbajtja e të paktën dy takimeve publike është obligim ligjor për komunat⁵ por nga qeveritë komunale pritet të kenë edhe konsultime me qytetarë për çështje dhe procese specifike si buxheti, planet urbane dhe rregulloret për fusha të ndryshme nën kompetencë të komunës.

Tabela 7: Konsultimet publike, lloji dhe numri

Konsultime Publike Komuna	Numri i konsultimeve të mbajtura 2019	Numri i konsultimeve të mbajtura 2018	Lloji i diskutimeve Vlerësimi deri në 31 Tetor 2019
Prishtinë	11	17	4 diskutime për rregullore – të gjitha në qytet 1 diskutim i përgjithshëm me publikun dhe kryetarin e komunës në Kuvendin e Komunës 6 diskutime për buxhet 2020 dhe KAB
Prizren	32	33	6 diskutime publike për rregullore 5 diskutime publike për hartat zonale 14 diskutime publike për buxhet 2020 dhe KAB 2020-2022 1 diskutim publik me kryetarin e komunës 5 diskutime publike për tema të veçanta






⁵ Ligj Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale. Kreu IX "Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes Qytetare". Neni 68: "Informimi publik dhe konsultimi". Gazeta Zyrtare, 2008.

Ferizaj	19	24	1 diskutim publik për themelimin dhe strukturimin e asamblesë komunale të fëmijëve 1 diskutim publik për planin e veprimit të zyrës për informim 5 diskutime për rregullore 1 diskutim publik për draft statutin për muzeun e kujtesës 1 diskutim i përgjithshëm me publikun dhe kryetarin e komunës 10 diskutime publike për buxhetin 2020
Pejë	22	24	3 diskutime publike për draft - rregullore 1 diskutim publik me qytetarët e Pejës për autostradën e Dukagjinit, e cila i lidh qytetet Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë dhe Prizren. 1 diskutim publik për KAB 1 diskutim i përgjithshëm me publikun dhe kryetarin e komunës 14 diskutime publike për buxhetin 2020 2 diskutime publike për tema të ndryshme
Gjakovë	26	15	2 diskutime publike për rregullore 9 diskutime publike për tema të veçanta 1 diskutim i përgjithshëm me publikun dhe kryetarin e komunës 1 diskutim publik për KAB 13 diskutime publike për buxhetin 2020
Gjilan	35	21	23 diskutime publike mbi planin zhvillimor komunal dhe hartat zonale 3 diskutime publike për rregullore komunale 1 diskutim i përgjithshëm me publikun dhe kryetarin e komunës 1 diskutim publik për temë të veçantë 7 dëgjime buxhetore për buxhetin 2020
Mitrovicë	11	9	2 diskutim publik për rregullore 2 sesione informuese për fermerët 7 diskutime publike për buxhet 2020

Komuna e Gjilanit ka mbajtur numrin më të madh të konsultimeve publike në periudhën janar-tetor 2019, përfshirë edhe takimin e Kryetarit me qytetarët. Ndërsa diskutimet publike për buxhet janë mbajtur në shtator – më vonë se në të gjitha komunat tjera. Kjo komunë i ka konsultuar qytetarët gjithashtu edhe për hartën zonale dhe rregullore komunale. Pas Gjilanit, komuna me numër të madh të konsultimeve publike është Prizreni me 32 takime, përfshirë dëgjimet për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022 të cilat i ka mbajtur më herët se të gjitha komunat tjera, diskutime publike për buxhetin 2020 si dhe takimin me kryetarin i cili është mbajtur një muaj me vonë. Ndërsa komunat tjerat kanë mbajtur numër relativisht të ulët të konsultimeve publike, kryesisht vetëm për rregullore komunale. Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit jo të gjitha komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për të mbajtur takim publik me kryetarin e komunës. Komuna e cila nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor është komuna e Mitrovicës, ndërsa komuna e Prishtinës edhe pse e ka organizuar këtë takim, njëjtë si vitin e kaluar, kryetari nuk ka qenë prezent dhe pjesëmarrës ka qenë vetëm një qytetar.

Konsultimet për buxhet 2020 dhe KAB 2020-2022

Sipas Ligjit për Menaxhimin dhe Shpenzimin e Parasë Publike, komunat kanë afat deri më datën 30 shtator që të dërgojnë propozim-buxhetet dhe kërkesat e tyre për ndarje buxhetore, ndërsa kryetari i komunës ka afat të dorëzojë projekt-buxhetin e vitit të ardhshëm tek Kuvendi i Komunës për shqyrtim deri më datën 1 shtator. Para se të dorëzohet tek Kuvendi i Komunës, ky propozim-buxhet duhet të prezantohet tek qytetarët e komunës, duke i ftuar ata në diskutime publike ashtu që qytetarët të kenë mundësi t'i paraqesin kërkesat e tyre me shpresë që adresimi i atyre kërkesave do të përfshihet në projekt-buxhetin final. Në mënyrë që planifikimi buxhetor të jetë sa më efikas dhe i përputhshëm ndaj nevojave të qytetarëve, është e nevojshme që qytetarët të marrin pjesë në këto takime.

KONSULTIMET PËR BUXHET KOMUNAL 2020					
	 DEGJIME BUXHETORE*	 JASHTË KUVENDIT	 ME PREZENCË TË KRYETARIT	 PJESËMARRËS	 PJESËMARRËS GRA
PEJË	14	9	10	498	89
PRIZREN	13	4	4	379	48
GJAKOVË	13	8	2	285	56
FERIZAJ	10	8	10	238	7
MITROVICË	7	0	2	114	35
GJILAN	7	5	0	110	27
PRISHTINË	6	0	0	57	10

* Përshihen edhe dëgjimet për Kornizën Afatmesme Buxhetore

Nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë, komuna e Pejës ka arritur të mbledhë më së shumti qytetarë në takimet publike për buxhet, duke mbledhur gjithsej 498 qytetarë. Njëkohësisht, është komuna e cila ka mbajtur më së shumti takime buxhetore – 14 gjithsej, përderisa 9 prej tyre nuk kanë qenë në qendër të qytetit, por në zona rurale. Pas komunës së Pejës radhitet komuna e




Prizrenit e cila ka mbledhur 379 qytetarë në dëgjime buxhetore, edhe pse vetëm 4 nga 13 dëgjimet e mbajtura i ka mbajtur jashtë sallës së Kuvendit të Komunës. Gjithashtu, kjo komunë ka ushtruar një praktikë ndryshe nga komunat tjera, duke mbajtur tetë dëgjime publike fillimisht për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022 gjatë muajit prill, ndërsa gjatë muajit gusht ka mbajtur edhe 5 dëgjime tjera për Buxhetin 2020. Gjakova, Ferizaj dhe Gjiçani kanë mbajtur shumicën e dëgjimeve publike jashtë sallës së Kuvendit të Komunës, duke iu ofruar më shumë mundësi për pjesëmarrje qytetarëve që jetojnë në zona rurale, ndërsa komuna e Mitrovicës dhe Prishtinës kanë mbajtur numër më të vogël të dëgjimeve publike – shtatë dhe gjashtë, respektivisht – dhe të gjitha janë mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës. Për dallim nga komunat tjera, komuna e Gjiçanit diskutimet publike me qytetarë i ka mbajtur gjatë muajit shtator.

Komuna me numrin më të vogël të pjesëmarrjes qytetare ka qenë komuna e Prishtinës – komuna me numrin më të madh të banorëve në Kosovë. Në gjashtë takimet e mbajtura, vetëm 57 qytetarë kanë marrë pjesë, ndërsa kryetari nuk ishte prezent në asnjërën nga takimet e mbajtura. Përkundër lajmërimit me kohë për planifikimin e mbajtjes së takimeve publike për buxhetin e vitit 2020, pjesëmarrja qytetare ishte e ulët duke rezultuar edhe në numër të vogël të kërkesave.

Shqetësuese është edhe fakti i numrit të vogël të pjesëmarrjes së grave në këto takime. Komuna me numrin më të vogël të pjesëmarrësve gra ka qenë komuna e Ferizajt me vetëm 7 gra nga 238 gjithsej. Në anën tjetër komuna e Pejës edhe pse ka arritur të mbledhë më së shumti qytetarë në dëgjimet publike për buxhet, prapëseprapë ka arritur që nga 498 pjesëmarrës të ketë vetëm 89 gra. Përderisa hartimi i buxhetit do të duhej t’iu përgjigjej nevojave të qytetarëve, mos pjesëmarrja në këto takime, e mbi atë mos pjesëmarrja e grave në takimet buxhetore vështirëson procesin e hartimit të një buxheti të mirëfilltë i cili do të përmbushte kërkesat e qytetarëve në nivel më të kënaqshëm.

Demokrati Plus ka evidentuar secilën kërkesë të shprehur gjatë takimeve buxhetore, si dhe përgjigjet që kanë marrë nga zyrtarët komunalë gjatë këtyre dëgjimeve. Kërkesat e qytetarëve përgjatë shtatë komunave kanë qenë kryesisht lidhur me shërbimet publike që i ofron komuna. Aspekti më problematik i dëgjimeve publike për buxhet është mos shpërndarja e informatave të nevojshme për këto takime. Në anën tjetër, profilizimi i këtyre takimeve, duke ofruar temë të veçantë të diskutimit në secilin takim e bën më të lehtë për qytetarët që të shprehin kërkesat e tyre në fushat që atyre iu interesojnë. Megjithatë, mbajtja e konsultimeve publike brenda një kohë shumë të shkurtë, siç është rasti i komunës së Prishtinës e cila ka mbajtur të gjitha dëgjimet publike për buxhet brenda një jave, e bën më të vështirë pjesëmarrjen qytetare në këto takime. Këto dëgjime publike duhet të shpërndahen edhe në lokalitet, por edhe në kohën e mbajtjes së tyre, në mënyrë që qytetarëve t’iu ofrohen më shumë mundësi për pjesëmarrje në këto takime. Pjesëmarrja e kryetarit të komunës në dëgjime publike, e sidomos dëgjime publike për buxhet, ofron bindjen tek qytetarët që kërkesat e tyre do të shqyrtohen. Në anën tjetër, mos-prezenca e kryetarit të komunës në këto dëgjime ka nxjerrë skepticizëm tek qytetarët që kërkesat e tyre do të merren parasysh.

Zotimi 4 – Transparenca në prokurim publik

ZOTIMI 4: Transparenca në prokurim publik	2019	Progresi nga viti 2018
Prishtina	 Përbushur	
Prizren	 Gjysmake	
Ferizaj	 Pa përbushur	
Peja	 Gjysmake	
Gjakova	 Kryesisht	
Gjilani	 Nivel i ulët	
Mitrovica	 Nivel i ulët	

Në fushën e prokurimit publik, për qëllimet e këtij vlerësimi dhe bazuar në zotimet elektorale të Kryetarëve, D+ i ka vlerësuar komunitetet nëse kanë plan të prokurimit të publikuar dhe të qasshëm në ueb faqet e tyre zyrtare, nëse i bëjnë publike kontratat dhe nëse mbajnë konsultime publike për planet e prokurimit.

Konsultimet për plane të prokurimit dhe publikimi i tyre

Sa i përket zotimit për mbajtjen e konsultimeve publike për planet e prokurimit, edhe pse nuk është obligim ligjor, Kryetarët janë zotuar se do t'i mbajnë ato. Megjithatë, në vitin e parë qeverisës, ky zotim pati ngecje në realizim nga të gjitha komunitetet nën monitorim sepse asnjëra nuk ka mbajtur konsultime të tilla. E njëjta praktikë është përsëritur edhe në vitin 2019 përderisa asnjë Kryetar nuk ka marrë iniciativë për të mbajtur konsultime publike për plan të prokurimit.

Ky zotim është i rëndësishëm për shkak se komunitetet mund të marrin rekomandime nga sektori privat dhe qytetarët në lidhje me kohën kur do të bëhet realizimi i projekteve të caktuara. Kjo përveç se e rrit numrin e rekomandimeve që komunitetet mund të marrë në lidhje me kohën e realizimit të projekteve, gjithashtu e rrit edhe informimin e qytetarëve për investimet që do të pasojnë. Kjo praktikë ndihmon në akomodimin e nevojave dhe planifikimit të sektorit privat, sidomos kur është në plan ndonjë investim i madh në hapësirë publike. Mirëpo, asnjëra nga shtatë komunitetet nuk i është përmbajtur këtij zotimi.

Për shkak të konkurrencës së drejtë dhe të barabartë për të gjithë komunitetin e biznesit, është parim i mirë që planet e prokurimit të publikohen në fillim vit për vitin aktual. Në fakt, nga muaji janar 2018, autoritete kontraktuese, në këtë rast komunitetet, janë të obliguara ta publikojnë planin e prokurimit për vitin aktual në ueb faqe, 15 ditë pas miratimit të buxhetit për vitin fiskal⁶. Për periudhën janar-qershor 2019 këtë plan e kanë të publikuar të 7 komunitetet e monitoruara.

⁶ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Janar 2012.

Tabela 8: Planet e prokurimit dhe mbajtja e konsultimeve për to

Rregulloret Komuna	Publikimi i Planit të prokurimit	Kur është publikuar plani i prokurimit për vitin 2019	Konsultime publike për planet
Prishtinë	PO	Mars 2019	JO
Prizren	PO	Shkurt 2019	JO
Ferizaj	PO	Shkurt 2019	JO
Pejë	PO	Shkurt 2019	JO
Gjakovë	PO	Shkurt 2019	JO
Gjilan	PO	Mars 2019	JO
Mitrovicë	PO	Shkurt 2019	JO

Komuna e Mitrovicës edhe pse e ka të publikuar planin e prokurimit, këtë dokument e kanë publikuar të skanuar, e që një pjesë e tij, përfshirë datat, nuk janë fare të dukshme.

Është e rëndësishme të ceket se njëri nga elementet e këtij zotimi – publikimi i kontratave nuk ka qenë obligim ligjor në kohën kur janë nënshkruar zotimet, megjithatë është pritur nga Kryetarët që ta mbajnë zotimin se do t'i përmbahen këtij parimi të Qeverisjes së Mirë. Por ndryshimin e rregullores "Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik" publikimi i kontratave të nënshkruara është bërë obligim ligjor për të gjitha autoritetet kontraktuese.

Duke i krahasuar njoftimet për nënshkrim nga platforma e e-prokurimit dhe kontratat e vitit 2019 të publikuara në ueb faqet e komunave, kemi arritur në numrin e kontratave të pa publikuara nga komunat respektive. Për dallim nga viti i kaluar ku publikimi i kontratave ishte një obligim i ri ligjor, këtë vit komunat do të duhej të ishin në efektive në publikimin e tyre, mirëpo për këtë gjashtë-mujor është vërejtur një trend i uljes në publikim të kontratave.







Në praktikën e publikimit të kontratave, vazhdon të jetë shqetësuese mos-publikimi i çmimeve për shërbimet e paguara, andaj ato kontratat të cilat kanë qenë në ueb mirëpo nuk kanë pasur informacione më të detajuara për çmimin e shërbimit nuk është llogaritur si e publikuar fare. Ky është rasti me komunën e Gjilanit e cila ka 7 kontrata të publikuara, porse iu mungojnë çmimet për shërbimet e ofruara. Gjithashtu, publikimi i kontratave të cilat nuk ndodhen në e-prokurimi ka qenë diçka që është hasur tek komuna e Ferizajt dhe Gjilanit, gjë e cila mund të nënkuptojë se kanë ndodhur parregullsi të mëdha në procedura të prokurimit, meqë këto kontrata kalojnë vlerën e 1 milionë euro në total.

Përveç publikimit të kontratave, është e rëndësishme publikimi i tyre të bëhet në kohë të njëjtë me nënshkrimin e tyre, në mënyrë që komuna të jetë më transparente. Andaj, në vlerësimin për publikimin e kontratave është marrë për bazë edhe koha kur këto kontrata janë publikuar në ueb. Për këtë shkak, komuna e Ferizajt nuk mund të vlerësohet se ka përmbushur zotimin për publikim të kontratave, meqë këto i ka publikuar në 15 korrik, si dhe në disa data të tetorit, kurse kontratat janë të nënshkruara në kohë të ndryshme të 2019-tës.

Tabela 9: Publikimi i kontratave

Publikimi i kontratave Komuna	Njoftimet për kontratat e nënshkruara në e-prokurim Janar-Tetor 2019	Kontratat e publikuara në ueb faqe Janar-Tetor 2019	Njoftimet për kontratat e nënshkruara në e-prokurim 2018	Kontratat e publikuara në ueb faqe 2018
Prishtinë	152	152	134	133
Prizren	145	121	164	108
Ferizaj	73	35	52	51
Pejë	95	79	64	55
Gjakovë	80	79	111	102
Gjilan	70	40	68	66
Mitrovicë	40	2	33	26

Zotimi 5 – Raporti vjetor për realizimin e premtimeve zgjedhore

ZOTIMI 5: Raporti vjetor për realizimin e premtimeve zgjedhore	2019	Progresi nga viti 2018
Prishtina	 Pa përbushur	=
Prizren	 Pa përbushur	=
Ferizaj	 Pa përbushur	✓
Peja	 Pa përbushur	=
Gjakova	 Pa përbushur	=
Gjilani	 Pa përbushur	=
Mitrovica	 Pa përbushur	=

Ky zotim vlerëson se a kanë kryetarët të publikuar ndonjë raport për realizimin e premtimeve zgjedhore për periudhën janar-dhjetor gjatë mandatit tyre qeverisës. Kryetarët janë zotuar se këtë raport të premtimeve do ta publikojnë në fund të vitit, gjë që nënkupton se tashmë në ueb do të duhej të ishte raporti për 2018. Vlerësimi i bërë deri në tetor 2019 tregon se asnjëri kryetar nuk e ka përbushur këtë zotim. Komuna e Ferizajt është vlerësuar se ka plotësuar këtë zotim deri diku për vitin 2018 për shkak se ka të publikuar një përmbledhje me të arriturat në secilën fushë të qeverisjes lokale të udhëhequr nga Kryetari, të titulluar “200 punë konkrete për Ferizajn dhe ferizajasit”, ndërsa për vitin 2019 nuk ka ndonjë raport të publikuar.

Zotimi 6 – Adresimi i ankesave qytetare në platforma online

ZOTIMI 6: Adresimi i ankesave qytetare në platforma online	2019	Progresi nga viti 2018
Prishtina	 Kryesisht	=
Prizren	 Kryesisht	=
Ferizaj	 Gjysmake	=
Peja	 Nivel i ulët	=
Gjakova	 Gjysmake	=
Gjilani	 Nivel i ulët	=
Mitrovica	 Nivel i ulët	=

Përgjegjshmëria e komunave ndaj ankesave të qytetarëve për shërbime publike është një kriter i qeverisjes së mirë komunale. Andaj edhe zotimi i fundit, por jo për nga rëndësia, është adresimi i ankesave qytetare në platforma online. Si burim për vlerësimin e këtij kriteri, D+ ka marrë platformën ndreqe.com pasi që të gjitha ankesat dhe ndërhyrjet e komunave evidentohen dhe janë publike. Përmes kësaj platforme qytetarët mund të raportojnë për tetë kategori të shërbimeve publike: ndriçimin publik, gropat në rrugë, ujërat e zeza, shenjat në rrugë, mbeturinat e pa mbledhura (përfshi deponitë ilegale të mbeturinave), trotuarët e dëmtuar, pengesa për persona me aftësi të kufizuara dhe “të tjera”.

Për këtë zotim, stafi i D+ ka ofruar asistencë të vazhdueshme për zyrtarët komunal të shtatë komunave nën monitorim, përmes ofrimit të trajnimeve në grupe të vogla për menaxhim të platformës, ofrim të llogarive admin në platformë me të gjitha kompetencat për menaxhim të statusit të raportimeve dhe komunikim më të drejtpërdrejtë me qytetarë. Gjithashtu, koordinatorët e terrenit kanë bërë verifikime të raportimeve dhe ndreqjeve në baza ditore, si dhe u kanë dërguar raporte javore zyrtarëve komunal dhe raporte mujore Kryetarëve, me lokacione të sakta dhe informata përcjellëse të raportimeve të qytetarëve. Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura numri i raportimeve nga qytetarët dhe numri i ndreqjeve nga komunat në vitin 2019. Komuna me numrin më të madh të raportimeve është ajo e Prishtinës, e njëjta e ka edhe numrin më të madh të ndreqjeve, mirëpo sa i përket reagimit të komunave ndaj kërkesave të qytetarëve, atëherë është komuna e Prizrenit ajo që del në vend të parë me numrin më të madh të ndreqjeve krahasuar me numrin e raportimeve. Numri i lartë i mesatares së ditëve nga raportimi deri te rregullimi tregon se komunat janë duke i rregulluar edhe raportimet e vjetra të qytetarëve, të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë mundur t'i rregullojnë më herët. Kjo tregon një gatishmëri që komunat t'i marrin parasysh ankesat e qytetarëve dhe të planifikojnë rregullimin e tyre, edhe nëse kalon një kohë pak më e gjatë.

Tabela 11: Numri i raportimeve dhe rregullimeve në platformën ndreqe.com

Raportimet & ndreqjet në platformën ndreqe.com Janar – Tetor 2019	Numri i raportimeve	Numri i ndreqjeve	% e raportimeve të rregulluara në total	Numri mesatar i ditëve nga raportimi deri në rregullim
Komuna				
Prishtinë	224	104	28,14%	253
Prizren	94	80	39,42%	172
Ferizaj	28	21	29,21%	331
Pejë	15	8	28,09%	328
Gjakovë	15	12	26,85%	247
Gjilan	16	4	8,34%	519
Mitrovicë	27	5	20,71%	673

Rekomandimet

Përgjatë monitorimit të shtatë komunave përgjatë viteve 2018 dhe 2019, Demokraci Plus ka arritur ti identifikojë një numër të sfidave dhe ngecjeve që komunat kanë hasur në përmbushjen e zotimeve për qeverisje të mirë. Zotimet e nënshkruara nga kryetarët mbi të gjitha janë praktika mjaft të thjeshta për tu përmbushur nëse ka vullnet. Në mënyrë që komunat ti përmbushin këto zotime plotësisht dhe duke parë praktikatat e komunave gjatë monitorimit, Demokraci Plus ka dalur me disa rekomandime të cilat do të siguronin qeverisje më të mirë dhe më transparente:

1. Publikimi i vendimeve të bëhet brenda një kohe të arsyeshme. Përderisa vendimet e kryetarit nuk kalojnë nëpër procedurë të vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria përgjegjëse, këto vendime do të duhej të publikoheshin në ditën e marrjes së tyre.
2. Format i publikimit të raportit të shpenzimeve duhet të unifikohet për të gjitha komunat njësojë. Gjithashtu, vendi i publikimit të raporteve financiare duhet të jetë i njejtë për të gjitha komunat e Kosovës. Përmbajtja e raporteve financiare duhet të jetë e detajuar ashtu që qytetarët me të vertetë të informohen se ku po shpenzohet paraja publike.
3. Qeverisja e mirë lokale nënkupton hartimin e politikave dhe buxhetit duke iu përshtatur kërkesave të qytetarëve. Mos-pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike bën që politikatat dhe vendimet që i miraton komuna të mos jenë në përgjigje të drejtëpërdrejtë ndaj kërkesave të qytetarëve. Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në konsultime publike mund të arrihet nëse këto konsultime mbahen në lokacione dhe kohë më të përshtatshme për qytetarët – në lagje, fshatra në kohë pas përfundimit të orarit të punës. Gjithashtu, duhen maksimalizuar shfrytëzimi i rrjeteve sociale, mediave lokale dhe mediave të formave tjera në ftesën e publikut për pjesëmarrje në këto konsultime publike.

4. Publikimi i kontratave nuk është e mjaftueshme për të siguruar transparencë në prokurimin publik. Publikimi i kontratave duhet të bëhet brenda dy ditëve pas nënshkrimit të kontratës. Në anën tjetër, kontratat e publikuara duhen të kenë çmimet për njësi të mallrave dhe shërbimeve të ofruara të bashkangjitura në publikim.

5. Duhet të krijohen ekipe të reagimit të shpejtë për raportime të ankesave qytetare për shërbime publike. Reagimi i shpejtë nuk nënkupton medoemos rregullimin e problemeve. Adresimi i ankesave përfshin edhe përgjigja ndaj ankesave të qytetarëve duke iu dhënë përgjigje zyrtare nga zyrtarët komunalë se kur do të mund të rregullohen problemet e regjistruara. Për këtë, kryetari duhet të punojë me udhëheqësit e dikasterit të administratës, shërbimeve publike dhe inspektoratit që të caktohen zyrtarët përgjegjës për administrim të ankesave të qytetarëve përmes platformave online, që në këtë rast ndreqe.com shërben si një platformë e tillë. Regjistrimi i ankesave qytetare në një platform online, si dhe administrimi dhe menaxhimi i tyre mundëson që zyrtarët komunalë të përpilojnë në mënyrë më efektive planet e aksionit për ndërhyrje në zona të ndryshme të komunave, si dhe të bëhet përpilim më efikasë i kontratave dhe buxhetit në tërësi.

6. Emërtimi i dokumenteve të publikuara duhet të jetë në harmoni me përmbajtjen e dokumentit. Emërtimi i gabuar i dokumenteve të publikuara vështirëson marrjen e informatave nga qytetarët.

Pasqyra e përmbushjes së zotimeve

	Zotimi 1	Zotimi 2	Zotimi 3	Zotimi 4	Zotimi 5	Zotimi 6
Prishtinë						
Prizren						
Ferizaj						
Pejë						
Gjakovë						
Gjilan						
Mitrovicë						

Legjenda

	Përbushur
	Kryesisht
	Gjysmake
	Nivel i ulët
	Pa përbushur

Duke marrë për bazë vlerësimin i cili detajohet më lartë për çdo zotim, D+ i ka vlerësuar në mënyrë objektive komunat nën monitorim për përmbushje të të gjitha zotimeve për Qeverisje të Mirë komunale. Secili nga gjashtë zotimet është karakterizuar si i “përbushur”, “kryesisht i përbushur”, përbushur në mënyrë “gjysmake”, “nivel i ulët” i përbushjes si dhe “i pa përbushur”.

Në rastet kur Kryetari ka vepruar gjatë kësaj periudhe ashtu siç është zotuar, zotimi është vlerësuar si tërësisht i përbushur. Disa nga zotimet kanë më shumë se një element dhe në këto raste është vendosur vlerësimi i zotimit si tërësi duke marrë parasysh përmbushjen e secilit element të tij. Konkretisht shpjegimi prapa vlerësimit të secilit zotim shpjegohet në vijim:

Zotimi i parë është vlerësuar si i përmbushur në qoftë se janë publikuar të gjitha vendimet e Kryetarit dhe të Kuvendit Komunal (në një kohë arsyeshme nga marrja e vendimit deri në publikim), si dhe janë publikuar dhe janë të qasshme rregulloret dhe planet urbanistike. Në rastet kur të gjitha këto elemente të zotimit janë respektuar, zotimi është notuar si i përmbushur. Kur një komune i ka munguar njëri element, për shembull planet urbane nuk kanë qenë të publikuara ose të qasshme, ajo komunë është vlerësuar se zotimin e parë e ka “kryesisht të përmbushur”. Në rastet planet nuk janë publikuar ose nuk kanë qenë të qasshme dhe komuna gjithashtu ka pasur një mesatare tejet të lartë të ditëve për publikim të dokumenteve që kërkohen në këtë zotim, atëherë ai zotim është vlerësuar me “nivel të ulët” të përmbushjes.

Zotimi i dytë është vlerësuar si i përmbushur përderisa komuna i ka publikuar raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve. Në ato raste kur raportet e shpenzimeve nuk kanë qenë të publikuara në vendin e caktuar, por rezultatet e konkurseve kanë qenë të publikuara, ky zotim është vlerësuar si “kryesisht i përmbushur”.

Zotimi i tretë është vlerësuar si “i përmbushur” nëse janë mbajtur konsultime të rregullta me banorë në lagje dhe fshatra, përfshi takimet publike në të dy gjashtë mujorët, dëgjime buxhetore dhe konsultime të tjera për çështje të ndryshme siç janë rregulloret, hartat zonale, etj. në lagje por edhe në fshatra të komunës. Nëse një komunë i ka mbajtur takimet publike dhe konsultime tjera por të gjitha dëgjimet buxhetore i ka mbajtur në Kuvend Komunal, është vlerësuar se zotimin e ka përmbushur “kryesisht”. Ndërsa, komunat që kanë mbajtur takimet publike dhe dëgjime buxhetore në lagje dhe fshatra, por nuk kanë mbajtur asnjë takim apo konsultim tjetër me qytetarë janë vlerësuar se e kanë përmbushur zotimin në “nivel të ulët”.

Zotimi i katërt: komunat që kanë publikuar planin e prokurimit në fillim të vitit (tre muajt e parë) dhe kanë të publikuar të gjitha kontratat janë vlerësuar se e kanë përmbushur “plotësisht” zotimin, edhe nëse nuk kanë mbajtur konsultime publike për plan të prokurimit. Komunat që nuk kanë mbajtur konsultime publike për planet e prokurimit, por i kanë shumicën e kontratave të 2019 të publikuara në ueb faqe, dhe e kanë publikuar planin e prokurimit brenda tre muajve të parë të vitit, janë vlerësuar se e kanë përmbushur zotimin “kryesisht”. Ato komuna të cilat nuk kanë mbajtur konsultime për planet e prokurimit, kanë numër të konsiderueshëm të kontratave të vitit 2019 të pa publikuara në ueb faqe, si dhe e kanë publikuar planin e prokurimit në mes të vitit apo edhe më vonë, janë vlerësuar se e kanë përmbushur zotimin në mënyrë “gjysmake”. Me “nivel të ulët” të përmbushjes janë vlerësuar komunat të cilat nuk kanë mbajtur konsultime për plane dhe nuk i kanë publikuar fare planet e prokurimit, edhe në qoftë se i kanë shumicën e kontratave të publikuara në ueb faqe.

Zotimi i pestë: Komunat që nuk e kanë publikuar raportin vjetor të progresit për realizimin e premtimeve zgjedhore në vitin e parë të këtij mandati qeverisës deri në fund të janarit 2019, janë vlerësuar se nuk e kanë përmbushur këtë zotim. Një komunë e cila të paktën e ka publikuar listen e të arriturave të premtimeve elektorale, është vlerësuar me përmbushje “gjysmake”.

Zotimi i gjashtë: edhe pse niveli i adresimit të ankesave të qytetarëve që kanë ardhur përmes platformës ndreqe.com mund të jetë mjet mjaft objektiv për matjen e përmbushjes së zotimit, në këtë rast në vlerësim kanë hyrë edhe elemente si: numri total i raportimeve, numri total i rregullimeve, si dhe numri mesatar i ditëve nga raportimi deri në rregullim.

Aneks 1: Zotimet e nënshkruara nga kandidatët për Kryetarë

A: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Prishtinës



Data: 10/10/2017

Kandidatët për Kryetar Komuna e Prishtinës

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përmbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënie, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, ZOTOHEM që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbjaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbjaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatrave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoje në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri, mbiemri (Subjekti)	Nënshkrimi	Data
<u>RIFAT DEBI ALTERNATIVA</u>		<u>10/10/2017</u>
<u>Sotim Dacelli</u>		<u>10.10.2017</u>
<u>ARBON BIRASINI</u>		<u>17.10.2017</u>
<u>ARBËR VUKASHIĆ</u>		<u>18.10.2017</u>
<u>LIRAK ÇELAD</u>		<u>18.10.2017</u>
<u>SHIPON AHMETI</u>		<u>19/10/2017</u>

B: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Prizrenit



Data: 9/10/2017

Kandidatët për Kryetar Komuna e Prizrenit

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përmbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënjë, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, ZOTOHEM që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatrave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoj në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri, mbiemri (Subjekti)	Nënshkrimi	Data
<u>Hekur Boshku</u>		<u>12.10.2017</u>
<u>Zafin Berisha</u>		<u>12.10.2017</u>
<u>Fulrim Kaboshi</u>		<u>13.10.2017</u>
<u>Veton Dija</u>		<u>18.10.2017</u>
<u>Arvan Kasumi</u>	(AKR)	<u>12.10.2017</u>
<u>Styri Dotoj</u>	PDK	<u>19.10.2017</u>
<u>MYTATHER HASKUKA</u>		<u>20.10.2017</u>

C: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Ferizajt



Data: 9/10/2017

Kandidatët për Kryetar Komuna e Ferizajt

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përmbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënje, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, ZOTOHEM që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoju në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri, mbiemri (Subjekti)	Nënshkrimi	Data
Faton Topalli	Lëvizja Vetëqeverisëse	12.10.2017
Besmirë Berisha	NISNA	11.10.2017
Amir Rexhepi	AKR	11.10.2017
Muhammed Skënder	LOK-Çfarë	14.10.2017
XHAVIË ZARIQI	AAK	12.10.2017
BASHKIM FAZIU-MIGRETI	DD	11.10.2017
DAJEM RAMNANI	PAI	15-10-2017.
AGIM ALIM -PDK	Mung	12.10.2017

D: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Pejës



Kandidatët për Kryetar Komuna e Pejës

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënie, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, ZOTOHEM që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbjaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbjaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatrave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoj në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri, mbiemri (Subjekti)	Nënshkrimi	Data
Aletmatifa		13.10.2017
Nisana		13.10.2017
PDK		13.10.2017
LUV		13.10.2017
AAK		13.10.2017
FJALA		13.10.2017
LDK		14.10.2017

E: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Gjakovës



Kandidatët për Kryetar Komuna e Gjakovës

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përmbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënie, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, ZOTOHEM që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatrave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoj në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri, mbiemri (Subjekti)	Nënshkrimi	Data
MIMOZA KUSARI-LILA (ALTERNATIVA)		12-10-2017
ARDIAN GJINI (AAK)		12.10.2017
EDMOND DUSHI (AKR)		12.10.2017
FAZLI Hoxha-Nisma		13.10.2017
BEKIM ERMELI		13.10.2017
RAMADAN HOTI		13.10.2017

F: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Gjilanit



Kandidatët për Kryetar Komuna e Gjilanit

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përmbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënie, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, ZOTOHEM që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatrave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoj në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri dhe mbiemri	Subjekti	Nënshkrimi	Data
<u>Zenun Pajaziti</u>	<u>PDK</u>		<u>14.10.2017.</u>
<u>NASER MORIJA</u>	<u>PD</u>		<u>14.10.2017</u>
<u>Armin Kurtosiq</u>	<u>LVV</u>		<u>16.10.2017</u>
<u>Reshep Kaulim</u>	<u>AAK</u>		<u>17.10.2017</u>
<u>Lufti E. HAZIRI</u>	<u>LDK</u>		<u>17/10/2017</u>
<u>BAJRAM HASANI</u>	<u>NISMA</u>		<u>18.10.2017.</u>

G: Zotimi nga kandidatët për kryetarë të Mitrovicës



Data: 10/10/2017

Kandidatët për Kryetar Komuna e Mitrovicës

ZOTIM ELEKTORAL

Qeverisja e mirë është bazë e një demokracie funksionale. Ne besojmë që pa marrë parasysh programin dhe projektet e Kandidatëve, secili nga ne duhet t'i përmbahet disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë. Votuesit dhe qytetarët meritojnë që të kenë zotimin tonë se do të jemi të dedikuar për transparencë, llogaridhënie, ndershmëri dhe vlera tjera demokratike në funksion të zhvillimit të komunës.

Andaj, përmes nënshkrimit të këtij dokumenti, **ZOTOHEM** që nëse zgjedhem Kryetar/e, do të:

1. Publikoj në ueb-faqe të komunës të gjitha vendimet, si dhe rregulloret e planet urbanistike në momentin që i përcillen Kuvendit Komunal për diskutim dhe aprovim;
2. Publikoj të gjitha raportet e shpenzimeve dhe rezultatet e konkurseve komunale;
3. Mbjaj konsultime publike për draftimin e planeve të prokurimit, publikimin e planeve dhe të kontratave;
4. Publikoj raportin vjetor për progresin e premtimeve elektorale;
5. Mbjaj konsultime të rregullta me banorë të lagjeve dhe fshatrave për ankesat dhe kërkesat e atyre lokaliteteve;
6. Adresoj në mënyrë të shpejtë ankesat e qytetarëve për shërbime publike që raportohen në komunë apo në platformat online.

Emri, mbiemri (Subjekti)	Nënshkrimi	Data
<u>Safet Kamberi</u>		<u>10.10.2017</u>
<u>FISNIK GJINAJ</u>		<u>10.10.2017</u>
<u>Esat Peci</u>		<u>10.10.2017</u>
<u>Nysret-Preteni</u>		<u>10.10.2017</u>
<u>Agim Bableri</u>		<u>11-10-2017</u>
<u>Qazim Shalca</u>	 <small>me një vjetër vjetër.</small>	<u>11-10-2017</u>
<u>Valdete Idrizi</u>		<u>11.10.2017</u>
<u>Ullenci Mulla</u>		<u>12/10/2017</u>
<u>FEHMI FERATI</u>		<u>12/10/2017</u>

Aneks 2: Vlerësimi i të gjitha zotimeve për gjashtë-mujorin e parë të 2019-tës

ZOTIMET E KRYETARIT PËR QEVERISJE TË MIRË KOMUNALE


Vlerësimi 6 mujor i komunave
Janar – Qershor 2019

* Radhitja e komunave sipas numrit të banorëve.






Zotimi	Prishtinë	Prizren	Ferizaj	Pejë	Gjakovë	Gjilan	Mitrovicë
1. Publikimi i Vendimeve	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Vendime të Kryetarit	61	186	118	92	190	2	39
Vendime të Kuvendit	26	16	22	26	31	26	40
Rregullore të miratuara	2	0	1	2	2	5	2
Plane urbane	23	0	0	13	9	0	0
2. Transparenca Financiare	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Raporteve të shpenzimeve	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Rezultateve të konkurseve	28	10	14	3	24	5	8
3. Konsultimet Publike	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sa janë mbajtur	13	1	3	17	1	5	1
4. Prokurimi Publik							
Publikimi i planeve të prokurimit	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Publikimi i Kontratave	0	0	0	0	0	0	0
Konsultime për plane të prokurimit	0	0	0	0	0	0	0
5. Raporti i Premtimeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Adresimi i raportimeve në ndreqe.com (Raportuar / Rregulluar)	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>	16 / 22 <input checked="" type="checkbox"/>



This project is financially supported by 'the Balkan Trust for Democracy, a project of the German Marshall Fund of the United States'



Aneks 3: Vlerësimi për dëgjimet publike për Buxhet 2020 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2020-2022

KONSULTIMET PËR BUXHET KOMUNAL 2020					
	 DEGJIME BUXHETORE*	 JASHTË KUVENDIT	 ME PREZENCË TË KRYETARIT	 PJESËMARRËS	 PJESËMARRËS GRA
PEJË	14	9	10	498	89
PRIZREN	13	4	4	379	48
GJAKOVË	13	8	2	285	56
FERIZAJ	10	8	10	238	7
MITROVICË	7	0	2	114	35
GJILAN	7	5	0	110	27
PRISHTINË	6	0	0	57	10

* Përshihen edhe dëgjimet për Kornizën Afatmesme Buxhetore

Aneks 4: Raportet financiare të tre-mujorit të parë të 2019-tës

	RAPORTI FINANCIAR Jan-Mars 2019		RAPORTI FINANCIAR Vjetor 2018		BUXHETI 2019
	NË UEB FAQE	NË KUVEND	NË UEB FAQE	NË KUVEND	NË UEB FAQE
	INVESTIMET KAP. PERFSHIHEN		INVESTIMET KAP. PERFSHIHEN		
PRISHTINA	+ Formati:	+	+ Formati:	+	+ Formati:
PRIZREN	+ Formati:	+	+ Formati:	+	-
FERIZAJ	+ Formati:	+	+ Formati:	-	-
PEJA	+ Formati:	-	+ Formati:	+	-
GJILAN	+ Formati:	+	+ Formati:	-	+ Formati:
GJAKOVA	+ Formati:	+	+ Formati:	+	-
MITROVICA	-	-	+ Formati:	+	-

LEQJENDA:

- Publikonë në baza majore por jo të detajuar
- Publikonë vetëm shifrat nga Buxheti i Kosovës

Formati: Open Data Word dokument
 Excel dokument PDF



This project is financially supported by: Election Trust for Democracy, a project of the Osborn Marshall Fund of the United States



DEMOCRACYPLUS

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

